Kronikë

# Tiranë/ Policia ndalon motomjetin, pasagjeri kapet me pistoletë në çantë, arrestohet 21-vjeçari (EMRI + VIDEO)

*Një kontroll i policisë në rrugën "Fitnete Rexha" në Tiranë çoi në arrestimin e një 21-vjeçari, i cili dyshohet se mbante pa leje një pistoletë me municion në çantën e tij*

Tiranë/ Policia ndalon motomjetin, pasagjeri kapet me pistoletë në çai
Report TV

Watch on

Redaksia
30 Qershor, 11:35 | **Përditesimi: 30 Qershor, 11:56**

Share Post

EASYPAY

Një 21-vjeçar është arrestuar në Tiranë pasi u kap me një armë zjarri pistoletë dhe municion, ndërsa lëvizte si pasagjer në një motomjet në rrugën "Fitnete Rexha". Në pranga ka rënë edhe drejtuesi i motomjetit, 31 vjeç, i akuzuar për veprën penale "Moskallëzimi i krimit".

Sipas Policisë, operacioni i koduar "Road" u finalizua nga Forca e Posaçme "Shqiponja", në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Nr. 4. Gjatë kontrollit ndaj 21-vjeçarit Erjon Hoxha, në çantën që mbante në sup u gjet dhe u sekuestrua një pistoletë me municion, që dyshohet se mbahej pa leje.

Në përfundim të veprimeve procedurale, E. H. u arrestua për veprën penale "Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak", ndërsa E. N., 31 vjeç, drejtuesi i motomjetit, për "Moskallëzimin e krimit". Materialet i janë referuar Prokurorisë për veprime të mëtejshme.



LEXO EDHE: **Spahiu: Organizatorët të bëjnë transparent çdo ditë numrin real të protestuesve! Që të marrësh përsipër zëvendësimin e institucioneve, nuk mjaftojnë as 100 mijë vetë në shesh**

**Njoftimi i plotë i Policisë së Shtetit**

> *"Finalizohet operacioni policor i koduar "Road". Qarkullonte i armatosur me pistoletë, si pasagjer në një motomjet, në rrugën "Fitnete Rexha", vihet në pranga 21-vjeçari.*
>
> *Në pranga edhe drejtuesi i motomjetit, për veprën penale "Moskallëzimi i krimit". Sekuestrohet një armë zjarri pistoletë dhe municion. Shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja", në bashkëpunim me shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 4, në vijim të kontrolleve intensive për goditjen e paligjshmërisë dhe rritjen e parametrave të sigurisë, finalizuan operacionin policor të koduar "Road".*
>
> *Gjatë operacionit, në rrugën "Fitnete Rexha", u ndalua për kontroll një motomjet me të cilin lëviznin shtetasit E. N., 31 vjeç, drejtues dhe E. H., 21 vjeç, pasagjer. Nga kontrolli i ushtruar ndaj shtetasit E. H., në çantën që mbante në sup, u gjet dhe u sekuestrua një armë zjarri pistoletë sëbashku me municion, të cilën dyshohet se e mbante pa leje.*
>
> *Në përfundim të veprimeve procedurale, u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit E. H., 21 vjeç, për veprën penale "Mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak", si dhe i shtetasit E. N., 31 vjeç, për veprën penale "Moskallëzimi i krimit". Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme"*

U.D/Shqiptarja.com

TAG: Tirane | policia e shtetit | pistolete | arme zjarri

**Komente**

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 30 Qershor, 22:00
**Pas 30ditësh, si ju duket fryma që po merr protesta?**

Më mirë | Më keq | Njëlloj

## Lajme të tjera



'Të rrethojmë parlamentin e mos lejojmë deputetët!' Kërcënimet nga sheshi para Kryeministrisë, thirrje protestuesve: Merrni vezë e miell me vete
1 Korrik, 19:11



Report Tv rindërton në 3D aksidentin me minibus, inxhinieri Hasanaj: Goditi bordurën e betonit, më pas barrierën! Shpejtësia rreth 100 km/h, shoferi s'reagoi gjatë përplasjes (VIDEO)
1 Korrik, 14:12



Gjykata e Tiranës shkurton orarin e sporteleve gjatë verës, ja kur do të ofrohen shërbimet për qytetarët
1 Korrik, 13:49



Sherr për gjobat e makinave, dhunohet analisti Ilir Demalia! Report Tv siguron foton e 2 autorëve
1 Korrik, 12:52



Valë e re emërimesh në Policinë e Shtetit, Hita firmos ndryshimet në komisariate dhe Akademinë e Sigurisë! Feliks Hodës i besohet komisariati 'problematik' i Sarandës
Sokol Dema
1 Korrik, 11:26



Protestuesit dorëzojnë në SPAK librin 'The Albanian Files': Përmbledhje e shkeljeve të Ramës, të hetohet! Dorëheqja e tij, e panegociueshme! (VIDEO)
1 Korrik, 10:18



Aksidenti në aksin Durrës-Tiranë/ 6 të plagosur lënë spitalin e Traumës, një i mitur dhe një 56-vjeçare çeke në reaminacion! Shoferi pësoi infarkt, po qarkullonte me shpejtësi brenda normave (VIDEO)
1 Korrik, 09:45




Kryepeshkopi Joan mesazh të rinjve: Bëhuni protagonistë të së mirës, të paqes, të përpjekjes dhe të dashurisë
30 Qershor, 20:56



Tone kërcënuese në protestë, organizatori Kola: Nga sot nuk mbajmë përgjegjësi për veprimet e popullit! Turma te Kryeministria shtyn dhe lag një grua (VIDEO)
30 Qershor, 19:28



Ylli Pata: Pse protesta po kërkon përplasjen?!
Ylli Pata
30 Qershor, 18:32



Taulant Balla publikon foto të Gentjan Prognit duke goditur policin me vezë: Është shkelës i shumëhershëm i ligjit! Kjo bandë kriminale po e përdor protestën për interesat e veta
30 Qershor, 18:12




Përmbysja e autobusit të linjës Berat-Tiranë, automjeti hiqet me karrotrec pas aksidentit tragjik
30 Qershor, 18:11















Lajmi i fundit



**Spahiu: Koha që protestuesit të krijojnë Partinë e Gjelbër, sepse mjedisi është katastrofë Kombëtare**
1 Korrik, 23:13



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje